



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS FRËNGE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Gjuhë Frënge C (3)

Ngarkesa: 4 ECTS, 40 orë seminare
Viti / Seminar: Viti II, semestri I
Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme
Programi i studimit: “Bachelor në Gjuhë Frënge”
Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJE E LËNDËS DHE REZULTATET E TË NXËNIT

Objektivat e përgjithshme lëndore: Të përvetësojë njohuri të elementeve gjuhësore të frëngjishtes në planin leksikor, sintaksor dhe gramatikor duke respektuar specifikat fonetike; Të zhvillojë aftësitë e vëzhgimit dhe analizës, si dhe shumë strategji të të nxënit që do të çojnë në mënyrë progresive drejt autonomisë gjuhësore; Të zhvillojë aftësitë për të zgjedhur dhe përdorur shprehjet dhe strukturat për t’u prezantuar, për të folur për veprimtaritë dhe zakonet, për të përshkruar, për të krijuar marrëdhënie, për të hyrë në jetën aktive përmes studimit dhe punësimit, për të ndërvepruar, për të shprehur dëshirat, për të analizuar e argumentuar, për të mobilizuar dhe për t’u përfshirë në aksione të karakterit shoqëror.

Objektivat e specifike lëndore:

Lënda synon që studenti :

- 1.Të kuptojë elementet minimale gjuhësore, leksikore
- 2.Të dallojë karakteristikat e tipave të ndryshme të teksteve
- 3.Të analizojë tekstet në mënyrë lineare
- 4.Të kuptojë tekstet në mënyrë të pavarur
- 5.Të jetë i aftë për një lexim analitik

Rezultatet e të nxënit:

- 1.Aftësia për të komunikuar dhe për t'u shprehur në gjuhën frënge.
- 2.Aftësia për të zhvilluar kompetencën e të menduarit.
- 3.Aftësia për të zhvilluar kompetencën e të nxënit.
- 4.Aftësia për të kryer punë të pavarur në gjuhën frënge.